1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë

anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;

- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për eficiency e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Fotokopje Multifunction B&W MFP Basic	cope	70
2	Fotokopje Multifunction B&W Copy Machine A3	cope	170
3	Fotokopje Multifunction Color MFP Basic	cope	10
4	Printer B&W Advanced	cope	15
5	Skaner Tipi 3	cope	20
6	Software Menaxhimi	cope	1
7	Software Monitorimi	cope	1
	Shuma e pajisjeve	cope	285

- a) Sasia e pajisjeve është e përafërt dhe mund të ndryshojë në varësi të nevojave të institucionit. Sasia e pajisjeve nuk mund të jetë më shumë apo më pak se 10% e totalit të kërkuar për të gjithë pajisjet.
- b) Pajisja të jete kompatibël me sistemet operative (Windows 10 dhe 11).
- c) Operatori ekonomik duhet të disponojë staf të certifikuar për pajisjet e ofertuara.
- d) Pajisjet duhet të implementohen brenda 30 ditësh nga firmosja e kontratës.
- e) Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 1 (nje) ore për defektet e pajisjeve brenda qytetit Tiranë si dhe të ketë servisën e tij ose kontratë servisi për shërbimin që kërkohej.
- f) Në rastet e defektimit të pajisjes, ajo të riparohet ose të ndërrohet brenda 24 orëve me një pajisje tjetër funksionale.

Këto pajisje do të instalohen:

- Në ambientet Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.1, Stacioni i policisë Qyteti Studenti dhe Stacioni i Policisë Farkë,
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.2,
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.3 dhe Stacioni i Policisë në Kamëz,
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.4,
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.5,
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.6,
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë Vorë.
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë Krujë
- Në ambientet e Komisarariatit të Policisë Fushe Kruje

KËRKESA TË PËRGJITHSHME E TË VEÇANTA

- Në çmimin e dhënë të përfshihen të gjitha pjesët konsumuese.
- Në çmimin e dhënë të përfshihen: Furnizimi me pajisje printimi, me letër, software për monitorimin e pajisjeve dhe menaxhimin e tyre, asistencën teknike, furnizimin me pjesë konsumi si tonera dhe pjesë të tjera.
- Pajisja do kryhet në bazë të faqeve të printuara, sipas grafikut të lëvritimit.
- Pajisjet duhet të implementohen brenda 30 ditësh nga firmosja e kontratës.
- Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 1 (nje) ore për defektet e pajisjeve brenda qytetit të Tiranës si dhe të ketë servisën e tij ose kontratë servisi për shërbimin që ne kërkojmë.
- Në rastet e defektimit të pajisjes, ajo të riparohet ose të ndërrohet brenda 24 orëve me një pajisje tjetër funksionale.

Fotokopje Multifunction B&W MFP Basic	
Karakteristika minimale teknike	
"Model":	Fotokopje/Printer/Skaner
Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4 B&W":	≥ 30 flete/min
Teknologjia "Technology":	Laser
Zvogëlim/Zmadhim "Reduction/Enlargement":	25% - 400%
Vendosja e Dokumentit "Document Feeder":	RADF
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min":	Min 3500

Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min Standard":	Min 3000
Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":	Po
Formati Maksimal i Letrës "Media Sizes":	A3
Memorja "Memory":	Min 2 GB
"Hard Disk":	Min 320 GB
Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":	Min 80 ipm
Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":	Min 600 x 600
Formati i Skanimit Maksimal "Maximum Scan Size":	A3
Porta e Komunikimit "Interface":	USB 2.0
"Ethernet":	Po
Software/Drivers CD:	Po
Kabëll "Power Cord":	Po
Shoqëruar me bazament me rrota për të lehtësuar lëvizshmërinë	Po, kompatibël me pajisjen

Fotokopje Multifunction B&W Copy Machine A3	
Karakteristika minimale teknike	
"Model":	Fotokopje/Printer/Skaner
Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4":	Min 25 flete/min
Teknologjia "Technology":	Laser B&W
Zvogëlim/Zmadhim "Reduction/Enlargement":	25% - 400%
Vendosja e Dokumentit "Document Feeder":	RADF
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min.":	Min 300
Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min. Standard":	Min 100
Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":	Po
Formati i Letrës "Media Sizes":	A3
Memorja "Memory":	Min 512 MB
"Hard Disk":	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":	Min 25 flete/min
Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":	Min 600 x 600 dpi
Formati i Skanimit Maksimal "Maximum Scan Size":	A3
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
Kabëll "Power Cord":	Po
Software/Drivers CD :	Po

FOTOKOPJE Multifunction Color MFP Basic	
Karakteristika minimale teknike	
"Model":	Copier, Printer, Skaner
Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4 B&W":	Min 25 faqe/min
Teknologjia "Technology":	Laser Color
Zvogëlim/Zmadhim "Reduction/Enlargement":	25% - 400%
Vendosja e Dokumentit "Document Feeder":	RADF
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min":	Min 6000
Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min Standard":	Min 4000
Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print":	Ethernet, USB
Formati Maksimal i Letrës "Media Sizes":	A3
Memorja "Memory":	Min 3 GB
"Hard Disk":	Min 300 GB
Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":	Min 150 ipm
Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":	Min 600 x 600 dpi
Formati i Skanimit Maksimal "Maximum Scan Size":	A3
Porta e Komunikimit "Interface":	USB 3.0
"Ethernet":	Po
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD	Po
Shoqëruar me bazament me rrota për të lehtësuar lëvizshmërinë	Po, kompatibël me pajisjen

PRINTER B&W Advanced	
Karakteristika minimale teknike	
Shpejtësia e printimit "Print speed" A4:	> 50 ppm
Teknologjia "Technology":	Laser
Rezolucioni i printimit minimal "Print quality":	Min 1200x1200 dpi
Kapaciteti në hyrje "input capacity"	Min 500 fletë
Pesha specifike e letrës "Media sizes":	60-120 g/m2
Formati i letrës "Media format":	A4/A5/Envelope
Aftësia e printimit duplex:	Po
Memorja "Memory":	> 512 MB
Komunikimi & menaxhimi	
Porta e komunikimit "interface":	High speed usb 2.0
Ethernet:	Po
Aksesorët	
Kabëll "Power cord":	Po, European

Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po

Skaner Tipi 3	
Karakteristika minimale teknike	
Tipi "Type":	CIS me Mekanizma per mbrojtjen e letrave
Formati "Format":	A4
Rezolucioni i Skanimit "Scanning	Min 600 dpi
Mënyra e Skanimit "Scan Mode":	Simplex dhe Duplex
Vendosja e Materialit "Media Feeder Type":	ADF
Kapaciteti i ADF "ADF Capacity":	Min 100 Fletë
Pesha specifike e letrës "Media sizes":	20-460 g/m2
Shpejtësia e Skanimit "Scanning Speed":	Min 50 ppm / 100 ipm (300 dpi)
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
Funksionet "Functions":	Pattern Noise Suppression, Edge Restoration, Punch Artifact Elimination, Detail Enhancement, Tab-Specific Cropping, Advanced Paper Safeguard ëith Smart Image Monitoring, Multi-Format Output Generation, Segmented Image Extraction, Standardized Color Output, Fixed Contrast Filtering, Line Artifact Suppression
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit " Interface":	High-Speed USB 3.2
"Drivers" + OCR Software:	Po, per për kapjen e të dhënave me lexim të barkodit, eksportim në format PDF/A(Anglisht, Italisht, Gjermanisht), JPEG2000 dhe Microsoft Word. OCR me mundesi eksporti ne (CSV, TXT, XML) te te dhenave identifikuese te ID dhe pasaportave
AKSESORËT	
Ushqyes + Kabëll "Power Supply + Cord" + Stampues:	Po, European. Të stampoje identifikues (si data apo kode) në anën e pasme të dokumentave pas skanimit, për të shërbyer si provë e timestamp
CD/DVD Drivers and Software:	Po, duke perfshire mundesi per te lexuar te dhenat e pasaportave
Kabëll për Komunikimin e të Dhënave "Data Cable":	(1) USB Cable

- Software për menaxhimin dhe monitorimin e pajisjeve te printimit dhe shërbimit.

Menaxhimi dhe kontrolli i realizimit te shërbimit ne sasi e cilësi do te behet me **Software**. Operatorit ekonomik do i lejohet akses vetem ne shikimin e numrit te faqeve, nderkohe qe do te jete Sektori Ekonomik, qe do te beje menaxhimin e dokumentave te fotokopjuara dhe skanuara.

Sistemi Menaxhimit

-
- Sistemi duhet të suportoje instalimin me mekanizma për high - availability.
 - Sistemi duhet suportoje instalim në sistem operativ Microsoft 2012 (64-bit) ose më të rinj, Red Hat 6.0+, Novell SUSE 12.0+ dhe Debian 10.0+.
 - Sistemi duhet të arrijë të punojë me databazën e integruar dhe me databaza të tjera, përfshirë me version min. MS SQL 2014, MS SQL Express 2014, PostgreSQL 12, MySQL 8.0, Oracle 12.2.0.3.
 - Sistemi për arsye sigurie duhet të arkivojë automatikisht shërbimet e printimit të përdoruesit, grupeve të përdoruesve ose pajisjeve.
 - Sistemi duhet të shfaqë mesazhe në ekranin e aplikacionit në terminalin e pajisjes.
 - Sistemi duhet të ofrojë një portal menaxhimi në web, i cili mund të aksesohet dhe kontrollohet vetëm nëpërmjet një web browser.
 - Sistemi duhet të lejojë akses në portalin administrativ nga interneti pa përdorur VPN.
 - Sistemi duhet të suportoje hyrjen në portal përmes një web browser duke përdorur mekanizmin SSO.
 - Sistemi duhet të suportoje menaxhimin e një apo me shumë serverave nga një lokacion i vetëm përmes portalit të sistemit.
 - Sistemi duhet të lejojë nivele të ndryshme të të drejtave të aksesit për përdoruesit e sistemit në modulit e menaxhimit në web.
 - Sistemi duhet të suportoje krijimin e planeve automatike të arkivimit.
 - Sistemi duhet të ofrojë në mënyrë të sigurt shërbimet e printimit dhe të skanimit të pajisja dhe përdoruesi.
 - Sistemi duhet të i pajisur me komunikimin të enkriptur midis të gjitha moduleve.
 - Sistemi duhet të bllokojë panelin e pajisjes së printimit deri sa përdoruesi të autorizohet me sukses.
 - Sistemi duhet të enkriptoje print jobs gjatë ruajtjes në server për funksionet Find Me dhe printimin e sigurt.
 - Sistemi duhet të suportoje replikimin e informacionit të përdoruesve nga MS Active Directory, eDirectory, Azure Active Directory, LDAP, OpenLDAP.
 - Sistemi duhet të suportoje mbledhjen e informacionit për përdoruesit nga grupet e përdoruesve të përzgjedhur.
 - Sistemi duhet të suportoje krijimin e përdoruesve lokalë.
 - Sistemi duhet të menaxhojë të gjitha pajisjet MFP të ofertuara nëpërmjet portalit web.
 - Sistemi duhet të suportoje menaxhimin e konfigurimit të disa pajisjeve njëherësh me veprime në bulk.
 - Sistemi duhet të mundësojë konfigurimin e pajisjeve automatikisht.
 - Sistemi duhet të mundësojë aksesimin e funksioneve të pajisjes pas autentikimit me të përdoruesve.
 - Sistemi duhet të mundësojë regjistrimin e kartave contacless për përdoruesin në pajisjet MFP.
 - Sistemi duhet të autentikojë përdoruesit në pajisjet MFP me ndihmën e një prej tre mekanizmave njëkohësisht:
 - Karte contacless ose fingerprint

-
- Kodi PIN
 - Login dhe domain password
 - Sistemi duhet të suportoje printimin nga sistemet e klasave ERP duke ruajtur funksionet e konfidencialitetit dhe gjurmimit të printimit.
 - Sistemi duhet suportoje dergimin e dokumenteve për printim nga pajisjet celulare të përdoruesve individualë.
 - Sistemi duhet të suportoje print jobs te dërguara me e-mail.
 - Sistemi duhet të lejoje printimet në formatet PCL, PCL6, HPGL, PostScript, PCL-GUI dhe XPS.
 - Sistemi duhet të delegojë automatikisht punët e printimit te përdorues të tjerë ose te grupe të përcaktuara në nivelin e administratorit të sistemit.
 - Sistemi duhet të bllokojë lëshimin e puneve te printimit nëse statusi i pajisjes nuk lejon printimin.
 - Sistemi duhet të pezullojë punët e printimit deri sa përdoruesi të autentikohet në pajisje dhe të zgjedhë punët për printim.
 - Sistemi duhet të sigurojë që përdoruesit mund të ndryshojne lokacion (komisariat, zyrat, etj.) pa pasur nevojë të konfigurojnë sërish printerin.
 - Sistemi duhet të ofrojë dynamic download të çdo printeri në bazë të lokacionit të përdoruesit.
 - Sistemi duhet të lejoje percaktimin ne radhët e printimit te përdoruesit në bazë të adresës IP ose subnet-it.
 - Sistemi duhet të lejoje percaktimin ne radhët e printimit te përdoruesit në bazë të grupeve të përdoruesve.
 - Sistemi duhet të lejoje percaktimin ne radhët e printimit te përdoruesit në bazë të hostname.
 - Sistemi duhet të lejoje dërgimin e dokumentave te skanuara në e-mail-in e përdoruesit në formën e një link-u të enkriptuar, nepermjet te cilit perdoruesi te mund ta shkarkoje.
 - Sistemi duhet të enkriptoje dokumentat e skanuara.
 - Mesazhet e sistemit duhet të përmbajnë informacion mbi kohën pas së cilës sistemi do të fshijë automatikisht dokumentin e skanuar nga serveri.
 - Shkarkimi i një dokumenti të skanuar mund të jetë i disponueshëm vetëm për përdoruesin që kryen procesin e skanimit në pajisje.
 - Ky proces skanimi duhet të suportoje dërgimin e dokumentave në formatet: pdf, searchable pdf, tiff, jpg, doc, docx.
 - Sistemi duhet të arkivojë punët e perfunduara te skanimit.
 - Sistemi duhet të mundesoje procesimin e skedarëve te skanuar dhe t'i ruajë ato ne shume destinacione njëkohësisht.
 - Sistemi duhet të suportoje dergimin e mesazheve alarm drejt nje adrese email te caktuar te Policise -i dhe të bllokojë printimin për dokumentet që përmbajnë fjalë ose fraza të paracaktuara.
 - Sistemi duhet të suportoje dergimin e mesazheve alarm drejt nje adrese email te caktuar te Policise -i dhe të bllokojë punën e skanimit për dokumentet që përmbajnë fjalë ose fraza të përcaktuara.
 - Sistemi duhet të procesojë një numër të pakufizuar faqesh OCR brenda periudhes së kontrates.
 - Sistemi duhet të personalizojë template-t e skanimit për përdorues ose grupe përdoruesish te ndryshem.

- Sistemi duhet t'i ofrojë përdoruesit mundësinë të skanojë drejt e-mail-it, folder-ave personale ose platformave cloud si Google Drive, OneDrive dhe SharePoint.
- Sistemi duhet të ofrojë përpunimin e dokumenteve për të:
 - krijuar dokumente të kërkueshme dhe të redaktueshme me tekst duke përdorur Optical Character Recognition (OCR),
 - prodhuar shumë skedare nga një skanim i vetëm duke përdorur ndarjen në grupe,
 - përpunuar skedaret me heqjen e faqeve bosh,
 - përmirësuar cilësinë vizuale të dokumentave duke korrigjuar pjerresine e imazheve të skanimit dhe pastrimin e imazheve nga njollat.
- Sistemi duhet të kufizojë punët e printimit dhe kopjimit për përdorues ose grupe përdoruesish.
- Sistemi duhet të mundesoje caktimin e kufizimeve automatike ose manuale për përdorues ose grupe përdoruesish.
- Sistemi duhet të monitorojë sistemin e printimit dhe të njoftojë administratorin për parregullsi duke dërguar e-mail në adresën e tij.
- Sistemi duhet të numërojë punët e printimit, kopjimit dhe skanimit.
- Sistemi duhet të numërojë sipas përdoruesit, kostove, pajisjeve, grupeve të pajisjeve dhe lokacioneve.
- Sistemi duhet të numërojë saktë numrin e faqeve me ngjyra dhe bardhë e zi në një punë të vetme printimi.
- Sistemi duhet të aplikojë kufizime për përdorues ose grupe përdoruesish.
- Sistemi duhet të mundesoje forcimin e printimit bardhë e zi edhe nëse është zgjedhur me ngjyra për grupe përdoruesish të përzgjedhur.
- Sistemi duhet të forcoje aplikimin e printimit dupleks edhe nëse është zgjedhur simplex për grupe përdoruesish të përzgjedhur.
- Për të ulur kostot e institucionit, sistemi duhet të suportoje limitime në printim duke konfiguruar kosto maksimale për një print job ose numër maksimal faqesh për grup përdorues të parazgjedhur.
- Sistemi duhet të suportoje printimin dhe përcaktimin e emrit ose prapashtesës (extension) së dokumentit.
- Sistemi duhet të suportoje punët e printimit vetëm për madhësitë e caktuara të letrës.
- Sistemi duhet të suportoje punët e printimit jo më të mëdha se madhësia e deklaruar e skedarit të printimit.
- Sistemi duhet të mundesoje dhe suportoje krijimin e watermark dhe identifikues unikë për punët e printimit.
- Sistemi duhet të krijojë një raport me të gjitha informacionet në sistem, me kërkesë të përdoruesit.
- Sistemi duhet të gjenerojë raporte manualisht ose automatikisht.
- Sistemi duhet të krijojë raporte të ndara sipas:
 - përdoruesit ose grupeve të përdoruesve,
 - pajisjeve ose grupeve të pajisjeve,
 - kostove,
 - lokacioneve,
 - numrit të faqeve të kursyera nga punët e paprintuara,
 - pajisjeve më të ngarkuara,
 - përdoruesve që printojnë dhe kopjojnë më shumë.
 - Licensuar për të gjithë pajisjet e ofertuara.

- Sistemi duhet të monitorojë pajisjet në kohë reale.
- Sistemi duhet të dërgojë njoftime për nivelet minimale të tonerave/konsumablave.
- Sistemi duhet të dërgojë njoftime për kodet Error të pajisjeve.
- Sistemi duhet të ofrojë monitorim proaktiv të tonerave dhe pjesëve konsumabel, duke dhënë njoftime për ndërrimin e tyre sipas ditëve të përdorimi dhe përqindjeve.
- Sistemi duhet të ofrojë krijimin e kërkesave të mirëmbajtjes për riparimin e pajisjeve.
- Sistemi duhet të ofrojë akses në një gamë të gjerë raportesh sipas pajisjeve dhe sipas lokacionit, për një periudhë të caktuar kohore.
- Sistemi duhet të ofrojë instalim vetëm on-premise.
- Sistemi duhet të ofrojë mundësinë për të pasur akses në informimin e gjendjes aktuale të pajisjeve.
- Sistemi duhet të monitorojë tonerat dhe pjesët e konsumueshëm dhe për pajisjet që do të lejohen vetëm me lidhje USB (jo në rrjet).
- Sistemi duhet të ofrojë matjen e kohës për zgjidhjen e problematikave.
- Sistemi duhet të ofrojë faturim automatik duke llogaritur faqet e printuara, formatet, kostot dhe faqet e përfshira në tarifën mujore.
- Sistemi duhet të jetë në përputhje me ISO-27001 për sigurinë e informacionit.
- Licensuar për të gjithë pajisjet e ofertuara.

Specifikimet teknike të Letrës A4

1	Letër fotokopje A4, 80 gr/m2 ngjyra e bardhe	Risma 500 flete
---	--	-----------------

- Serveri

Serveri në të cilin do të instalohet software që do të menaxhojë sistemin e monitorimit do të sigurohet nga ana e operatorit ekonomik. Ky server do të jetë në përdorim të DVP Tirane. Aksesit në këtë server do të jetë vetëm i stafit të brendshëm të DTL. Serveri duhet të ketë specifikime minimale: 1 x CPU 8 core, 128 GB DDR4 RAM, 2 x 2.5" SSDs, RAID 0/1/5/10, 4 x PCIe 5.0 x16, 5 x USB 2.0, 2 x DP

- Pajisjet hardware të memories

Pajisjet hardware të memories (HDD/SSD/RAM/SD/MINISD...) të cilat memorizojnë të gjithë informacionin që ka të bëjë me serverin, printimet, skanimet dhe fotokopjimet nuk duhet të ndërrohen pa arsye. Në momentin e përfundimit të kontratës apo për nevojën të shërbimit të pajisjeve si: riparime, ndërrime etj., pajisjet hardware të memories (HDD/SSD/RAM/SD/MINISD...) duhet t'i dorëzohen me procesverbal komisionit të mbikëqyrjes së kontratës nga ofruesi i shërbimit dhe për efekt sigurie do të mbeten në pronësi të DPPSH.

- Siguria e informacionit

Palët bien dakord dhe konsiderojnë si rreptësisht konfidenciale të gjitha informacionet të komunikuar mes tyre në lidhje me aktivitetin e punës së DVP Tirane dhe të mos bëjnë publike informacione të tilla, tërësisht apo pjesërisht, çdo personi i tretë. Këto informacione të mos përdoren për ndonjë qëllim tjetër të ndryshëm nga sa përcaktohet në këtë marrëveshje.

Ofruesi i Shërbimit do të garantojë dhe bëjë të mundur që të gjithë punëmarrësit e tij të respektojnë konfidencialitetin për çdo dokument apo të dhëna që vijnë në dijeni gjatë ushtrimit të shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve. Në rast të shkeljes së detyrimeve të përcaktuara, DVP Tirane ka të drejtë të zgjidhë menjëherë kontratën dhe të kërkojë ç'dëmtim për dëmin e shkaktuar. Ruajtja e konfidencialitetit do të vazhdojë për një afat të papërcaktuar edhe pas përfundimit të kësaj kontrate.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

Nr.	Emërtimi i artikullit ose shërbimit	Njësia	Sasia	Afati i ekzekutimit
1	Printim fotokopjim bardh e zi	Faqe/A4	12,800,000	36 muaj
2	Printim fotokopjim ngjyra	Faqe/A4	250,000	36 muaj
3	Skanim	Faqe/A4	100,000	36 muaj
4	Leter	Flete/A4	11,000,000	36 muaj

Afatet e ekzekutimit: 36 muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbim printimi i menaxhuar”

Detyrat: Sipas shtojces 6

Shpërndarja: Sipas shtojces 6

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas shtojces 6

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 **Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:** Sipas shtojcës 9

2.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se vlera e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Nj/M	Sasia
1	Fotokopje Multifunction B&W MFP Basic	cope	70
2	Fotokopje Multifunction B&W Copy Machine A3	cope	170
3	Fotokopje Multifunction Color MFP Basic	cope	10
4	Printer B&W Advanced	cope	15
5	Skaner Tipi 3	cope	20
6	Software Menaxhimi	cope	1
7	Software Monitorimi	cope	1
	Shuma e pajisjeve	cope	285

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- a. Deklarate ku të cilesohet prodhuesi i pajisjeve dhe nëse keto pajisje ofertuesi i ka/do të ketë në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje.

-
